



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12 paragrafët 1 dhe 2 shkronja d), neneve 24.2; 40 paragrafët 1 dhe 2 shkronja c), të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, neneve 2, 8 dhe 10 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, si dhe neneve 15 paragrafët 1 dhe 2.4; nenet 21.2 dhe 34 paragrafët 1 dhe 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2021, miratoi këtë,

VENDIM

PËR FALJEN E OBLIGIMEVE TË KRIJUARA / BORXHEVE NGA TAKSA PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE AFARISTE

Neni 1

Me këtë vendim falen obligimet e krijuara / borxhet nga taksa komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste për të gjitha subjektet afariste të regjistruara në Komunën e Podujevës, përkatësisht 4763 subjekte afariste, në shumë të gjithmbarshme 3,856,046.00€ (*tre milion e tetëqind e pesëdhjetë e gjatë mijë e dyzetë e gjashtë euro*), dhe përfshinë periudhën kohore nga data 01 janar 2002 deri më datë 25 gusht 2021.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdesen Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr. 01-430/04-0085315/21
Podujevë,
27 shtator 2021



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi